

Edicioni i Shtatë

Projektimi i Strukturave prej Betoni të Armuar











sipas Eurokodit 2

Bill Mosley, John Bungey dhe Ray Hulse



**Projektimi i strukturave prej
betoni të armuar
sipas Eurokudit 2**

Tituj të tjerë më të shitur nga Palgrave Macmillan



Projektimi i strukturave prej betoni të armuar sipas Eurokodit 2 edicioni i shtatë

Bill Mosley


*Formerly Senior Teaching Fellow,
Nanyang Technological Institute, Singapore*

John Bungey

*Emeritus Professor of Civil Engineering,
University of Liverpool, UK*

Ray Hulse

*Formerly Associate Dean,
Faculty of Engineering and Computing,
Coventry University, UK*



© W. H. Mosley and J. H. Bungey 1976, 1982, 1987, 1990

© W. H. Mosley, J. H. Bungey and R. Hulse 1999, 2007, 2012

All rights reserved. No reproduction, copy or transmission of this publication may be made without written permission.

No portion of this publication may be reproduced, copied or transmitted save with written permission or in accordance with the provisions of the Copyright, Designs and Patents Act 1988, or under the terms of any licence permitting limited copying issued by the Copyright Licensing Agency, Saffron House, 6-10 Kirby Street, London EC1N 8TS.

Any person who does any unauthorised act in relation to this publication may be liable to criminal prosecution and civil claims for damages.

The authors have asserted their rights to be identified as the authors of this work in accordance with the Copyright, Designs and Patents Act 1988.

First published 2012 by
PALGRAVE MACMILLAN

Palgrave Macmillan in the UK is an imprint of Macmillan Publishers Limited, registered in England, company number 785998, of Houndmills, Basingstoke, Hampshire RG21 6XS.

Palgrave Macmillan in the US is a division of St Martin's Press LLC, 175 Fifth Avenue, New York, NY 10010.

Palgrave Macmillan is the global academic imprint of the above companies and has companies and representatives throughout the world.

Palgrave[®] and Macmillan[®] are registered trademarks in the United States, United Kingdom, Europe and other countries

ISBN-13: 978-0-230-30285-3 paperback

This book is printed on paper suitable for recycling and made from fully managed and sustained forest sources. Logging, pulping and manufacturing processes are expected to conform to the environmental regulations of the country of origin.

A catalogue record for this book is available from the British Library.

A catalog record for this book is available from the Library of Congress.

10 9 8 7 6 5 4 3 2 1
21 20 19 18 17 16 15 14 13 12

Titulli origjinal:
Reinforced Concrete Design to Eurocode 2

Autorët:
Bill Mosley, John Bungey, Ray Hulse

Publikimi i parë nga Palgrave Macmillan
ISBN origjinale: 978-0-230-30285-3

Drejtues grupi të përkthimit dhe redaktimit shkencor: Merita Guri, Endri Duro, Ilda Rusi

Përgatiti për botim dhe dizajn: Elda Hoxha, Sirjana Rumi
Kopertina: Elda Hoxha, Sirjana Rumi
Shtypur nga shtypshkronja: PEGI

Grupi i përkthimit:
Doc. Dr. Merita Guri (Kapitulli 1)
Ph.D. Ilda Rusi (Kapitulli 2, Kapitulli 4)
Ph.D.c Endri Duro (Kapitulli 9, Kapitulli 10)
Ph.D.c Aguljeln Marku (Kapitulli 5, Kapitulli 7)
Ph.D.c Nikolla Vesho (Kapitulli 6)
Ph.D.c Flogerta Krosi (Kapitulli 3, Kapitulli 11)
Ph.D.c Blerim Nika (Kapitulli 12)
MSc. Enxhi Sulaj (Kapitulli 8, Kapitulli 13)
MSc. Albi Alliaj (Parathënie, Falënderime, Simbolet, Shtojcat, Indekset)

Tiranë, 2022
© Copyright për botimin në shqip Universiteti Polis
Ky libër u financua nga Polis_PRESS, Universiteti Polis
ISBN:



SERIA E PUBLIKIMEVE SHKENCORE TË UNIVERSITETIT POLIS
POLIS_PRESS

Dedikuar të gjitha familjeve tona për inkurajimin dhe
durimin e tyre gjatë shkrimit të këtij teksti

Përmbajtja

<i>Parathënie</i>	<i>Faqja x</i>
<i>Mirënjohjet</i>	xii
<i>Simbolet</i>	xiii
1. Hyrje në projektim dhe vetitë e betonit të armuar	1
1.1 Proceset e projektimit	2
1.2 Veprimi i përbashkët	6
1.3 Marrëdhëniet sforcim-deformim	8
1.4 Turrja dhe bymimi	11
1.5 Deformkoha	15
1.6 Durabiliteti	16
1.7 Karakteristikat e materialeve	16
2. Projektimi sipas gjendjes kufitare	20
2.1 Gjendjet kufitare	21
2.2 Rezistencat e materialeve dhe ngarkesat karakteristike	22
2.3 Koeficientet e pjeshme të sigurisë	23
2.4 Kombinimi i veprimeve	28
2.5 Koeficienti global i sigurisë	32
3. Analiza e strukturës në gjendjen e fundit kufitare	33
3.1 Ngarkesat	34
3.2 Kombinimet dhe llojet e ngarkesave	35
3.3 Analiza e trarëve	36
3.4 Analiza e ramave	43
3.5 Struktura dhe mure që punojnë në prerje që u rezistojnë ngarkesave horizontale	53
3.6 Rishpërndarja e momenteve	58
4. Analiza e seksionit	63
4.1 Lidhja sforcim-deformim	64
4.2 Shpërndarja e sforcimeve dhe deformimeve të një seksioni tërthor në përkulje	65
4.3 Përkulja dhe epjura ekuivalente drejtkëndore e sforcimit	67
4.4 Seksioni drejtkëndor me armaturë 1-fishe në përkulje sipas gjendjes së fundme kufitare	68
4.5 Seksioni drejtkëndor me armaturë 2-fishe në përkulje sipas gjendjes së fundme kufitare	72
4.6 Seksionet me prerjen tërthore në formë T-je me pllakë në pjesën e sipërme, në përkulje sipas gjendjes së fundme kufitare	77
4.7 Rishpërndarja e momentit dhe ekuacionet llogaritëse	84
4.8 Përkulja me ngarkesë aksiale në gjendjen e fundme kufitare	88

4.9	Epjura drejtkëndore-parabolike e sforcimit	96
4.10	Epjura trekëndore e sforcimit	98
5.	Prerja, inkastrimi dhe përdredhja	104
5.1	Prerja	105
5.2	Inkastrimi i shufrave	117
5.3	Xhuntimi i armaturave	121
5.4	Analiza e seksioneve nën efektin e përdredhjes	123
6.	Shërbyeshmëria, durueshmëria dhe kërkesat e qëndrueshmërisë	
6.1	Kërkesat e detajimeve	129
6.2	Raportet e thellësisë me hapësirën dritë-efektive	140
6.3	Llogaritjet e spostimeve	142
6.4	Plasaritjet nga përkulja	154
6.5	Plasaritjet termike dhe nga tkurrja e betonit	159
6.6	Kërkesa të tjera të shërbimit	163
6.7	Kufizimi i dëmtimeve të shkaktuara nga ngarkesat aksidentale	166
6.8	Kërkesa të tjera të shërbimit	171
7.	Projektimi i trarëve betonarme	176
7.1	Analiza paraprake dhe dimensionimi i elementit	178
7.2	Projektimi për përkuljen e një seksioni drejtkëndor me asnjë rishpërndarje të momentit	180
7.3	Projektimi për përkuljen e një seksioni drejtkëndor me rishpërndarje të momentit	185
7.4	Trarët me flanaxha	189
7.5	Trarët me një hapësirë	193
7.6	Projektimi në prerje	194
7.7	Trarët e vazhduar	198
7.8	Trarët konsol, trarët e shkurtër dhe trarët e thellë	204
7.9	Zvogëlimi dhe inkastrimi i shufrave përforcuese	210
7.10	Projektimi për përdredhjen	212
7.11	Kërkesat e shërbimit dhe qëndrueshmërisë	216
8.	Projektimi i soletave prej betoni të armuar	217
8.1	Prerja në soleta	218
8.2	Raporti gjatësi-thellësi efektive	224
8.3	Rregullat e armimit	225
8.4	Soletë monolite e mbështetur në një drejtim	226
8.5	Soletë monolite e mbështetur në dy drejtime	231
8.6	Soleta të sheshta	236
8.7	Soleta me traveta	244
8.8	Soleta e shkallëve	249
8.9	Metoda e linjës së rrjedhshmërisë dhe rripave	252
9.	Projektimi i kolonës	261
9.1	Ngarkesa dhe momentet	262
9.2	Klasifikimi i kolonave dhe mënyrat e shkatërrimit	263
9.3	Detajet e armimit	267
9.4	Kolonat e shkurtra që u rezistojnë momenteve dhe forcave aksiale	269
9.5	Seksionet jodrejtkëndore	279
9.6	Përkulja biaksiale e kolonave të shkurtra	282
9.7	Projektimi i kolonave të holla	285
9.8	Muret	289
10.	Themelet dhe muret mbajtëse	292
10.1	Themelet Plint	296

10.2 Themelet e kombinuara	303
10.3 Themelet e lidhura	307
10.4 Themelet e vazhduara	308
10.5 Themelet pllakë	311
10.6 Themelet me pilota	312
10.7 Projektimi i jastëkut të pilotave	316
10.8 Muret mbajtëse	320
11. Betoni i paranderur	331
11.1 Parimet e paranderjes	333
11.2 Metodatat e paranderjes	334
11.3 Analiza e seksionit të betonit nën ngarkesat e punës	336
11.4 Projektimi për gjendjen kufitare të shërbimit	341
11.5 Analiza dhe projektimi në gjendjen e fundme kufitare	365
12. Strukturat ujë-mbajtëse	381
12.1 Qëllimi dhe parimet	382
12.2 Fugat në strukturat mbajtëse të ujit	385
12.3 Detajet e përforcimit	388
12.4 Podrumet dhe depozitat nëntokësore	389
12.5 Metodatat e projektimit	390
13. Strukturat kompozite	407
13.1 Procedura e projektimit	410
13.2 Projektimi i traut të çelikut për kushtet gjatë konstruksionit (vetëm për trarë të pambështetur)	411
13.3 Seksioni i përbërë në gjenden kufitare të fundme	414
13.4 Projektimi i bulonave	418
13.5 Përforcimi tërthor në flanaxhën e betonit	423
13.6 Kontrolltet e deformimit për gjendjen kufitare të shërbimit	426
<i>Shtojcat</i>	431
<i>Për më shumë informacion</i>	442
<i>Indekset</i>	444

Parathënie

Qëllimi i këtij libri është të bëjë një prezantim të drejtpërdrejtë të parimeve dhe metodave të projektimit për strukturat prej betoni. Ai u drejtohet kryesisht studentëve dhe inxhinierëve të rinj, të cilët kërkojnë të kuptojnë teoritë bazike dhe një udhëzues konciz të procedurave të projektimit. Megjithëse metodat e projektimit janë përgjithësisht të bazuara në standardet europiane (Eurokode), shumica nga teoritë dhe praktikat janë thelbësore dhe prandaj është i nevojshëm edhe në vende jashtë Europës.

Kërkimi për harmonizimin e standardeve teknike përgjatë Komunitetit Europian (KE) ka sjellë zhvillimin e një serie të këtyre Eurokodeve Strukturore, të cilat janë dokumente teknike të hartuara me qëllim që të adoptohen nga të gjithë shtetet anëtare. Përdorimi i përbashkët i këtyre standardeve ka si qëllim të ulë barrierat tregtare dhe t'u mundësojë kompanive të konkurrojnë në kushte gati të barabarta brenda EC. Eurokod 2 (EC2) merret me projektimin e strukturave të betonit dhe në Mbretërinë e Bashkuar ka zëvendësuar BS8110. Eurokod 2 përbëhet nga 4 pjesë dhe ka huazuar parimet e gjendjeve kufitare të vendosura në standardet britanike. Ky libër i referohet kryesisht pjesës së parë, që merret me rregullat e përgjithshme për ndërtimet. Eurokodi 2 duhet të përdoret i bashkangjitur me standardet e tjera europiane, duke përfshirë edhe Eurokodin 0 (Bazat e Projektimit), që merret me analiza dhe Eurokod-in 1 (Ngarkesat), që ka të bëjë me ngarkimin e strukturave. Standarde të tjera të nevojshme janë Eurokod 7 (projektimi gjeoteknik) dhe Eurokod 8 (projektimi sizmik).

Disa organe të Mbretërisë së Bashkuar kanë përpiluar gjithashtu një sërë dokumentesh plotësuese, të cilat japin komente dhe një sfond shpjegimesh. Dokumentet e tjera plotësuese përfshijnë, përkatësisht për çdo shtet, Anekset Kombëtare, të cilat japin informacion të detajuar për secilin shtet anëtar duke u mbështetur nga Mbretëria e Bashkuar, nga standardet britanike të publikuara PD 6687:2006, që përmbajnë të dhënat plotësuese. Përveç kësaj, Qendra e Betonit ka prodhuar *Eurokodin konciz për projektimin e ndërtesave prej betoni*, i cili përmban material të përzgjedhur nga EC2, por paraqitet në një mënyrë që e bën atë më miqësor ndaj përdoruesit, krahasuar me Eurokodin kryesor dhe përmban vetëm atë informacion që është thelbësor për projektimin e strukturave më të përditshme të betonit. Instituti i Inxhinierëve Strukturalist ka publikuar një variant të ri të Manualit të Projektimit. Këto dy dokumentet e fundit përmbajnë gjithashtu informacion që nuk është i përfshirë në EC2, siç janë diagramet e projektimit dhe metodat e projektimit, të marra nga standardet britanike.

Prezantimi i EC2 është orientuar drejt zgjidhjes kompjuterike të ekuacioneve, merr parasysh betone me rezistencë më të lartë dhe është krejt ndryshe nga ajo e BS8110.

Sidoqoftë, tipari thelbësor i EC2 është që parimet e projektimit të përfshira në dokument janë pothuajse identike me parimet që janë dhënë në BS8110. Prandaj, megjithëse janë disa ndryshime në detajime, inxhinierët që cilët janë mësuar të projektojnë me standardet e mëparshme britanike, nuk duhet të kenë vështirësi në kuptimin e veçorive të EC2. Në këtë botim përfshihen dy karakteristika: përdorimi i klasave të reja të armaturës së çelikut dhe projektimi duke u bazuar në rezistencën cilindrike të betonit.

Ndryshimet në terminologji, që rrjedhin pjesërisht nga ndryshimet gjuhësore, kanë sjellë prezantimin e disa termave të rinj që ndoshta nuk janë shumë familjarë për inxhinierët e Mbretërisë së Bashkuar. Më e dukshme nga këto ndryshime është përdorimi i *veprimeve* për të përshkruar ngarkimin në struktura dhe përdorimi i termave të ngarkesave të *përhershme* dhe të *përkohshme* për të përshkruar ngarkesat nga pesha vetjake dhe nga ato të përkohshme. Përgjatë këtij teksti, terminologjia është mbajtur sa më shumë të ishte e mundur në të njëjtën linjë me praktikën në Mbretërinë e Bashkuar prandaj, për shembull, termi “*ngarkesat*” është përdorur zakonisht, por jo ekskluzivisht, në vend të termit “*veprimet*”. Terminologjia tjetër “e re” identifikohet në momente të përshtatshme në tekst.

Lënda në këtë libër është rregulluar në mënyrë që kapitulli 1 deri tek ai i 5-të të merren kryesisht me teori dhe analiza, ndërsa kapitujt vijues të mbulojnë projektimin dhe detajimin e elementeve dhe strukturave të ndryshme. Në mënyrë që të përfshihen tema që janë të zakonshme të një kursi universitar, përmban pjesë mbi projektin sizmik, strukturat mbajtëse të tokës, si dhe kapituj mbi betonin e parandëruar dhe konstruksionet e përbëra.

Një kapitull i ri është shtuar rreth strukturave ujë-mbajtëse, së bashku me një kapitull që përfshin projektimin e trarëve të thellë. Gjithashtu janë bërë shtesa dhe modifikime që të reflektojnë interpretimin që bëhet në Mbretërinë e Bashkuar dhe praktikën në përdorimin e EC2, që nga fillimi i përdorimit të tij. Figura dhe shembuj shtesë janë shtuar për të ndihmuar të kuptuarit, si dhe është shtuar një seksion i ri në Kapitullin 1 për të siguruar një hyrje në proceset e projektimit. Kjo përfshin shqyrtimin e projektimit konceptual, qëndrueshmërisë dhe shëndetit & sigurisë, si dhe rolin e softuerit kompjuterik në projektim.

Ekuacionet e rëndësishme që janë nxjerrë brenda tekstit shenjohen me një yll ngjitur me numrin e ekuacionit dhe në Shtojcë është dhënë një përmbledhje e ekuacioneve kryesore. Kur ka qenë e nevojshme të përfshihet material që nuk është siguruar drejtpërdrejt nga Eurokodet, është mbështetur në praktikën e mirë të pranuar aktualisht në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjatë përgatitjes së këtij botimi të ri, qëllimi ka qenë që të ruhet struktura dhe tiparet e edicionit të 5-të të mëparshëm të librit të *Projektimit të Betonit të Përforcuar*, nga Mosley, Bungey dhe Hulse (Palgrave), i cili bazohet në standardet britanike. Duke krahasuar të dy librat është e mundur të krahasohen ndryshimet thelbësore midis Eurokodit 2 dhe standardeve të mëparshme britanike dhe të krahasohen rezultatet e ndryshme kur strukturat janë të projektuara me secilin kod.

Duhet theksuar se Kodet e Praktikës janë gjithmonë të prirura për t'u riformuluar dhe lexuesit duhet të sigurohen që ata janë duke përdorur botimin e fundit të çdo standardi përkatës.

Në fund, autorët dëshirojnë të falënderojnë Z. Charles Goodchild (Qendra e Betonit) dhe Dr. Steve Jones (Universiteti i Liverpulit), për komentet dhe sugjerimet e tyre të dobishme gjatë shkrimit të këtij botimi.

Mirënjohjet

Leja për të ripërdorur të dhëna nga BS EN 1995-1-1: 2004 dhe BS EN 1990: 2002 është dhënë nga Instituti i Standardeve të Britanisë (ISB). Është i ndaluar çdo përdorim tjetër i këtij materiali. Standardet e Britanisë mund të merret në pdf ose në format të printuar nga dyqanet online të ISB: Tel. +44(0)20 8996 9001, Email: cservices@bsigroup.com.

Ne shprehim gjithashtu mirënjohjet tona dhe falënderojmë ARUP që na dha leje për të ripërdorur fotografitë e treguara në kapitujt 2 dhe 7. Leja për të ripërdorur fotografitë e Entit të Mirëmbajtjes së Kanalizimeve të Minuorth-it në kapitullin 12 është një xhentilesë nga ana e Pick Everard. Fotografia e “The Tower”, “East Side Plaza”, “Portsmouth” (kapitulli 1) janë ripërdorur falë dashamirësisë së Stephenson RC Frame Contractor, Oakwood House, Guildford Road, Buck Green, Horsham, West Sussex. Fotografitë në kapitujt 8, 9 dhe 13 janë bërë të mundura nga "iStock.com".

Simbolet

Simbolet janë në përgjithësi sipas EC2 dhe ato më kryesore janë listuar më poshtë. Simbole të tjera janë shpjeguar gjatë tekstit kur ka qenë e nevojshme.

E	moduli i elasticitetit
E_d	vlera e projektimit për veprimet gjatë gjendjes kufitare të fundme
F	ngarkesat (veprimet)
G	ngarkesa e përhershme
I	momenti i inercisë
K	treguesit e humbjes nga parandërja
M	momenti ose momenti përkulës
N	forca aksiale
Q	forca variabël
T	momenti përdredhës
V	forca prerëse
a	deformimi
b	gjerësia
d	thellësia efektive e përforcimit në tërheqje
d'	thellësia e përforcimit në shtypje
e	jashtëqendërsia
f	sforcimi
h	thellësia totale e seksionit në planin përkulës
i	rrezja e momentit të inercisë
k	koeficient
l	gjatësia ose hapësira e dritës
n	ngarkesa e fundme për njësinë e sipërfaqes
l/r	kurbëzimi i një trau
s	hapi i përforcimit në prerje ose thellësia e bllokut të betonit, që llogaritet se do t'iu rezistojë sforcimeve në shtypje
t	trashësia
u	perimetri i sforcimeve shpuese
x	thellësia e aksit neutral
z	krahu i momentit mes forcave të brendshme të betonit në shtypje dhe forcave të përforcimit në tërheqje në seksionin e betonit

A_c	sipërfaqja e seksionit tërthor të betonit
A_p	sipërfaqja e seksionit tërthor të kavove të paranderura
A_s	sipërfaqja e seksionit tërthor të përforcimit në tërheqje
A_s^f	sipërfaqja e seksionit tërthor të përforcimit në shtypje
$A_{s, req}$	sipërfaqja e seksionit tërthor të përforcimit në tërheqje të kërkuar gjatë gjendjes kufitare të fundme
$A_{s, prov}$	sipërfaqja e seksionit tërthor të përforcimit në tërheqje të dhënë gjatë gjendjes kufitare të fundme
A_{sw}	sipërfaqja e seksionit tërthor të përforcimit në prerje në trajtën e stafave apo kthimit të shufrave
E_{cm}	moduli sekant i elasticitetit të betonit
E_s	moduli i elasticitetit të armimit prej çeliku ose çeliku të paranderur
G_k	ngarkesat e përhershme karakteristike
I_c	momenti sekondar i sipërfaqes së betonit
M_{bal}	momenti që i korrespondon gjendjes së ekuilibrit
M_{ED}	vlera e momentit gjatë projektimit
M_u	momenti i rezistencës së fundme
N_{bal}	ngarkesa aksiale në një kolonë, që i korrespondon gjendjes së ekuilibrit
N_{ED}	vlera e forcës aksiale gjatë projektimit
P_0	forca fillestare nga paranderja
Q_k	ngarkesa e përkohshme karakteristike
T_{ED}	vlera gjatë projektimit të momentit përdredhës
V_{ED}	vlera gjatë projektimit të forcës prerëse
W_k	ngarkesat karakteristike të erës
B_w	gjerësia minimale e seksionit
f_{ck}	rezistenca karakteristike e matur me kampione cilindrike të betonit
f_{cm}	rezistenca mesatare e matur me kampione cilindrike të betonit
f_{ctm}	rezistenca mesatare në tërheqje e betonit
f_{pk}	rezistenca karakteristike e rrjedhshmërisë së çelikut të paranderur
f_s	rezistenca e çelikut
f_{sc}	rezistenca e çelikut në shtypje
f_{st}	rezistenca e çelikut në tërheqje
f_{yk}	rezistenca karakteristike e rrjedhshmërisë së betonit
g_k	ngarkesa e përhershme karakteristike për njësinë e sipërfaqes
k_1	sforcimi mesatar në shtypje i betonit për bllokun e sforcimeve parabolike të seksionit drejtkëndësh
k_2	një tregues që merr parasysh lidhjen mes thellësisë nga qendra e bllokut të sforcimeve parabolike të seksionit drejtkëndësh dhe thellësisë nga aksi neutral
l_a	treguesi krah/thellësi efektive = z/d
l_0	lartësia efektive e kolonës ose murit
q_k	ngarkesa e përkohshme karakteristike për njësinë e sipërfaqes
α	koeficienti i zgjerimit termik
α_e	raporti i moduleve
ψ	koeficienti i kombinimit të ngarkesave
γ_c	koeficienti parcial i sigurisë për rezistencën e betonit
γ_f	koeficienti parcial i sigurisë për ngarkesat (veprimet), F
γ_G	koeficienti parcial i sigurisë për ngarkesat e përhershme, G
γ_Q	koeficienti parcial i sigurisë për ngarkesat e përkohshme, Q
γ_S	koeficienti parcial i sigurisë për rezistencën e çelikut
δ	treguesi i rishpërndarjes së momentit
ε	deformimet relative
σ	sforcimet

φ	diametri i shufrave të çelikut
A_a	sipërfaqja e seksionit të profilin prej çeliku
A_v	sipërfaqja prerëse e seksionit të profilin prej çeliku
B	gjerësia e flanaxhave prej çeliku
b_{eff}	gjerësia efektive e flanaxhave prej betoni
d	thellësia e saktë e rrjetës prej çeliku ose diametri i konit të shkaktuar nga buloni në prerje
E_a	moduli i elasticitetit të çelikut
$E_{c,eff}$	moduli efektiv i elasticitetit të betonit
E_{cm}	moduli sekant i elasticitetit të betonit
f_{ctm}	vlera mesatare e sforcimit në tërheqje aksiale të betonit
f_y	vlera nominale e sforcimit të rrjedhshmërisë të çelikut strukturor
f_u	sforcimi i fundëm në tërheqje i specifikuar
h	thellësia e përgjithshme; trashësia
h_a	thellësia e seksionit të çelikut strukturor
h_f	trashësia e flanaxhës prej betoni
h_p	thellësia e përgjithshme e fletës së profilin prej çeliku pa marrë parasysh stampimet
h_{sc}	lartësia nominale e përgjithshme e bulonës lidhëse që punon në prerje
I_a	momenti sekondar i inercisë e seksionit të çelikut strukturor
I_{transf}	momenti sekondar i inercisë i sipërfaqes prej betoni të transformuar dhe të sipërfaqes së çelikut strukturor
k_l	tregues reduktimi për rezistencën e kokave të bulonave me fletë profili prej çeliku strukturor paralele me traun
k_t	tregues reduktimi për rezistencën e kokave të bulonave me fletë profili prej çeliku strukturor pingul me traun
L	gjatësi, hapësirë drite
M_c	momenti i rezistencës së seksionit të kompozit
n	raport modular ose numri i elementeve lidhëse në prerje
n_f	numri i elementeve lidhëse në prerje për gjithë nyjat që punojnë në prerje
P_{Rd}	vlera e projektimit të rezistencës në prerje të një elementi të vetëm lidhës
R_{cf}	rezistenca e flanaxhave prej betoni
R_{cx}	rezistenca e betonit sipër aksit neutral
R_s	rezistenca e seksionit prej çeliku
R_{sf}	rezistenca e flanaxhave prej çeliku
R_{sx}	rezistenca e flanaxhave prej çeliku sipër aksit neutral
R_v	rezistenca e thellësisë efektive të brinjës
R_w	rezistenca e thellësisë së përgjithshme të brinjës
R_{wx}	rezistenca e brinjës sipër aksit neutral
t_f	trashësia e flanaxhave prej çeliku
t_w	trashësia e brinjës prej çeliku
$W_{pl,y}$	moduli plastik i seksionit i një seksioni prej çeliku struktural
\bar{x}	distanca deri te qendra e seksionit
z	krahu
δ	deformimet në mes të hapësirës së dritës
ε	konstante e barabartë me $\sqrt{235/f_y}$ ku f_y është në N/mm ²
γ	koeficient sigurie
ν_{Ed}	sforcimi në prerje gjatësore i flanaxhave prej betoni
η	koeficient parcial i nyjave që punojnë në prerje n/n_f



1

Hyrje në projektim dhe vetitë e betonit të armuar

Hyrje e kapitullit

Projektimi strukturor mund të konsiderohet si një seri fazash të ndërlidhura dhe të mbivendosura. Shprehur më thjeshtë, këto faza përbëhen nga:

- *Projektimi konceptual (Projekt-ide)*, në të cilin do të merren parasysh një sërë formash strukturore dhe materialet që mund të realizohen.
- *Projektimi paraprak*, i cili do të përfshijë llogaritjet e thjeshta dhe të përafërta për të vlerësuar qëndrueshmërinë e një sërë zgjidhjesh alternative konceptuale.
- *Projektimi i detajuar (Projekt zbatimi)*, i cili do të përfshijë analizat e plota dhe llogaritjet për skemat e përzgjedhura.


Betoni i armuar është një material ndërtimi i fortë dhe i qëndrueshëm, i cili mund të përdoret për forma dhe madhësi të ndryshme, duke filluar nga një tra ose kolonë e thjeshtë me seksion drejtkëndësh deri në kupola ose kupola të lakuara. Realizimi i këtyre formave arrihet duke kombinuar vetitë më të mira të betonit dhe çelikut.

Ky kapitull do të paraqesë vetëm një prezantim të shkurtër të çështjeve kryesore që duhet të merren parasysh në projektim, vetitë kryesore të betonit, si dhe çelikut si përforcues i tij. Për një studim më gjithëpërfshirës rekomandohet referenca e teksteve të specializuara dhe faqeve të internetit të renditura në fund të librit.

1.1 Proceset e projektimit


Tri fazat themelore të identifikuar më sipër nuk kanë natyrë lineare, siç ilustrohet në figurën 1.1, por përfshijnë një seri ripërsëritjesh në të cilat alternativat krahasohen, modifikohen dhe përmirësohen për të prodhuar një zgjidhje të realizueshme duke marrë parasysh kërkesat dhe kufizimet.

Figurë 1.1
Natyra përsëritëse e projektimit



Kjo do të kërkojë që të bëhen supozime, gjykime dhe të ndërmerren vendime në bazë të informacionit të disponueshëm, që shpeshherë është jo i plotë. Qëllimi është të arrihet një ekuilibër midis realizimit të projektit, duke përfshirë funksionin dhe qëndrueshmërinë, ekonominë, financat, kohën dhe burimet, duke marrë në konsideratë mjedisin së bashku me shëndetin dhe sigurinë. Kjo është e ilustruar në figurë 1.2.

Figurë 1.2
Kriteret e balancimit të projektimit



Lehtësia e ndërtimit (ndërtueshmëria) me fuqi punëtore, aftësi dhe pajisje në dispozicion do të jetë e rëndësishme, së bashku me sigurimin për mirëmbajtjen në të ardhmen.

1.1.1 Fazat e projektimit

Më lart janë identifikuar tri faza themelore të projektimit: faza konceptuale, faza paraprake dhe faza e detajuar.

Projektimi konceptual

Kjo është faza e parë e procesit të projektimit dhe kërkon shumë vëmendje, përtej llogaritjeve që lidhen me fazat e mëvonshme, duke përdorur parimet dhe procedurat, të cilat formojnë bazat e këtij libri.

Në veçanti, së pari është e nevojshme të kuptohen plotësisht kërkesat e klientit, si dhe projekt-ideja. Përveç aspekteve të treguara më lart, duhet të identifikohet çdo kërkesë e veçantë e lidhur me vendndodhjen e objektit (duke përfshirë kushtet e tokës), përdorimin e objektit (duke përfshirë izolimin akustik, termik, ose rrezatimin dhe performancën dinamike), gjithashtu edhe kodet dhe rregulloret përkatëse. Qëndrueshmëria duhet të merret në konsideratë si gjatë ndërtimit, ashtu edhe në përdorim duke pasur parasysh caktueshmërinë ose pacaktueshmërinë e formës së strukturës, si dhe qëndrueshmërinë nën ngarkesa aksidentale, përfshirë shpërthimin ose përplasjet e automjeteve. Gjithashtu, duhet të merren parasysh çështjet estetike, të qëndrueshmërisë dhe çështjet mjedisore. Procesi mund të përfshijë një gamë të gjerë profesionistësh, si arkitektë, inxhinierë strukturistë dhe inxhinierë gjeoteknikë, të cilët është shumë e rëndësishme që të përfshihen në një fazë të hershme për projekte të mëdha. Komunikimi i mirë midis tyre është çelësi drejt një projekti të suksesshëm.

Hapi i parë mund të përfshijë hedhjen e ideve për të identifikuar alternativat e paraqitjes, formës strukturore dhe materialeve në bazë të kërkesave dhe kufizimeve. Këto do të pasohen nga llogaritjet paraprake bazuar në vlerësimet fillestare të dimensioneve dhe ngarkesave për të krijuar fizibilitetin strukturor. Në këtë fazë do të përdoren metoda të përafërta dhe skica që janë në shkallë të përafërta.

Projektimi paraprak

Kjo fazë fillestare e llogaritjes, siç u përshkrua dhe më lart, do të ndihmojë për të përcaktuar qëndrueshmërinë e zgjidhjeve të mundshme konceptuale dhe do të mundësojë zhvillimin dhe përsosjen e tyre. Procedurat fillestare zakonisht do të bazohen në llogaritjet me dorë, të cilat mund të çojnë në analiza të mëvonshme kompjuterike për strukturat më komplekse.

Projektimi i detajuar

Në këtë fazë do të vendoset një zgjidhje, e cila do të analizohet plotësisht duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme dhe të sakta për të bërë llogaritjet e holësishme, vizatimet dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për llogaritjen e kostos së ndërtimit.

1.1.2 Llogaritjet me dorë

Këto llogaritje zakonisht përfshijnë një analizë të thjeshtuar, për elemente të strukturës të cilat supozohen se thjesht mbështeten ose fiksohen plotësisht, si dhe përdorimin e elementeve ndihmëse të projektimit, siç janë tabelat dhe grafikët që janë dhënë në këtë libër. Ngarkesat në përgjithësi do të konsiderohen si të shpërndara njëtrajtësisht ose të përqendruara në një pikë. Këto llogaritje do të përdoren për të vlerësuar dhe krahasuar qëndrueshmërinë e skemave të ndryshme të propozuara, duke përfshirë edhe mundësinë e zgjidhjeve të ndryshme të themeleve. Llogaritjet me dorë do të jenë gjithashtu të rëndësishme për të kontrolluar zgjidhjet e mara nga projektimi me kompjuter.

Kontrollet e tjera konfirmojnë se rritja e ngarkesave të kolonave në nivelin e dyshemesë përputhet me ngarkesën në mbështetje të dyshemesë dhe që shuma e momenteve (mbështetje + hapësirë) në një tra është $wl^2/8$ kur aplikohet një ngarkesë e shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme mbi të gjithë hapësirën.

Përgjatë këtij libri janë punuar shembuj që theksojnë përdorimin e llogaritjeve me dorë, të tilla që lexuesi mund të fitojë një koncept të parimeve themelore të projektimit me beton të armuar dhe të forcojë aftësinë për të kryer llogaritjet e zakonshme dhe jo të zakonshme të projektimit që priten nga një inxhinier kompetent.

1.1.3 Roli i kompjuterave

